



Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të neneve 2.2, 3.4, 15.1 (a), (c), (d), (e), (j), 21.2, 57 dhe 59 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta zyrtare" e Republikës së Kosovës, Viti III, Nr. 28, 4 qershor 2008),

Me qëllim të ndryshimit dhe plotësimit të Rregullores Nr. 8/2014 për kushtet dhe mënyrën e transportimit të mallrave të rrezikshme përmes ajrit të datës 25 tetor 2014,

Në pajtim me nenin 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2012 mbi procedurat e konsultimit publik të palëve të interesuara,

Nxjerr këtë:

**RREGULLORE Nr. 01/2015 PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES Nr. 8/2014
PËR KUSHTET DHE MËNYRËN E TRANSPORTIMIT TË MALLRAVE TË
RREZIKSHME PËRMES AJRIT**

Neni 1

Neni 37, paragrafi 1, zëvendësohet me sa vijon:

37.1 Transportuesit, shpediterët e mallrave, ofruesit e shërbimeve të trajtimit në tokë, agjentët e trajtimit të mallrave dhe operatorët që nuk kanë Certifikatë për operim ajror (AOC) të lëshuar dhe që nuk veprojnë në përputhje me kërkesat e Aneksit III të Rregullores (EEC) 3922/91 (të EU-OPS), duhet t'i zbatojnë plotësisht dispozitat e kësaj rregulloreje, dhe për të vazhduar me kryerjen e aktiviteteve që lidhen me transportin e mallrave të rrezikshme përmes ajrit, do të zotërojnë një certifikatë të mallrave të rrezikshme të lëshuar nga AACK, në pajtim me këtë rregullore jo më vonë se 30 qershor 2015.

Neni 37, paragrafi 3, zëvendësohet me sa vijon:

37.3 Operatori i caktuar i postës do t'i nënshtrohet plotësisht dispozitave të neneve 20.5, 25.6 dhe 25.11 të kësaj rregulloreje, jo më vonë se 30 qershor 2015.

Neni 37, paragrafi 4, zëvendësohet me sa vijon:

37.4 Ofruesit e trajnimit duhet t'i zbatojnë plotësisht dispozitat e kësaj rregulloreje, në mënyrë që të vazhdojnë kryerjen e aktiviteteve që lidhen me

trajnimin mbi mallrat e rrezikshme dhe duhet të posedojnë certifikatën e ofruesit të shërbimeve të trajnimit të lëshuar në pajtim me këtë rregullore, jo më vonë se 30 qershor 2015.

Neni 2

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 1 prill 2015.

Prishtinë, 13 mars 2015

Dritan Gjonbalaj
Drejtore i Përgjithshëm